



KONFERENCA
Diaspora Flet

KORNIZA LIGJORE
DHE INSTITUCIONALE PËR
PËRFSHIRJEN E DIASPORËS

PLANI I VEPRIMIT TË FORCIMIT INSTITUCIONAL

MAJ 17-20, 2018

Krijimi i Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare

OBJEKTIVA

Qëllimi i këtij komponenti të Planit të Veprimit të Germin-it është krijimi i Këshillit Global të Diasporës Shqiptare, që do të jetë jo-politik dhe do të shërbejë si një urë zyrtare institucionale ndërmjet shqiptarëve brenda dhe jashtë vendeve të tyre.

QËLLIMET TONA

1. Krijimin e një Këshilli i cili do të nxisë pjesëmarrjen më aktive të diasporës shqiptare në çështjet politike, ekonomike, sociale dhe kulturore të vendeve të tyre;
2. Zhvillimin e një Këshilli që do të ketë një rol zyrtar këshillimor (jo përfaqësues) për çështjet e Diasporës me qeveritë e Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe përfaqësuesve të komunitetit shqiptar që jetojnë në Luginën e Preshevës, në Serbinë Jugore; dhe
3. Mbajtjen dhe forcimin e një Këshilli i cili do të sigurojë përkujdesjen dhe mbrojtjen e vazhdueshme të Diasporës shqiptare, qofte nga vendet e origjinës por edhe nga vetë diaspora shqiptare.

HISTORIKU

Kombi shqiptar numëron rreth 10 milionë njerëz që shtrihen në shumë vende brenda dhe jashtë Ballkanit Perëndimor. Historikisht, diaspora shqiptare ka qenë e angazhuar dhe ka mbështetur duke i dhënë një përkrahje shpëtimtare për vendet e tyre në nevojë. Ajo ka qenë relativisht e mirë organizuar në nivel lokal dhe nganjëherë kombëtar, por tani është koha për të krijuar një institucion vërtetë ndërkombëtar / global me degë në shumë vende. Fakti që Shqipëria ishte një vend praktikisht i mbyllur për shumë vite gjithashtu ka minuar angazhimin dhe organizimin e diasporës shqiptare. Duke pasur parasysh se diaspora shqiptare ka fituar një pasuri të madhe njohurish, përvojash dhe burimesh financiare gjatë dekadave të fundit, mendojmë se tani është koha për të krijuar një këshill

ndërkombëtar që do të promovojë një qasje globale të shekullit 21 ndaj angazhimit të diasporës shqiptare.

Për më tepër, Qeveria e Shqipërisë më datë 5 prill 2018 miratoi një ligj për miratimin e themelimit të Këshillit të Diasporës (shih Aneksin për detaje), prandaj mendojmë se propozimi ynë është në kohën e duhur për këtë arsye. Ligji propozon që këshilli të përbëhet nga 15 anëtarë të Diasporës si më poshtë: 3 SHBA, 2 Kanada, 6 Evropë, 2 Britani e Madhe, 1 Turqi dhe 1 Australi. Ne planifikojmë të punojmë së bashku me Ministrinë e Diasporës në Shqipëri dhe me Agjencinë Kombëtare Shqiptare të Diasporës në Tiranë bazuar në një Memorandum Mirëkuptimi të nënshkruar nga Germin me Ministrinë e Diasporës në Shqipëri më 21 Mars 2018. Natyrisht, ne gjithashtu planifikojmë të punojmë me (dhe përafërsisht shpresojmë të nënshkruajnë Memorandume Mirëkuptimi) me Ministrinë e Diasporës dhe Investimeve Strategjike në Kosovë, si dhe Ministrinë për Çështjet e Diasporës në Maqedoni).

METODOLOGJIA

Grupi ynë punoi nga shtatori 2017 deri në Maj 2018 për të zhvilluar rekomandimet tona. E gjithë puna është bërë virtualisht pasi e gjitha ishte pro bono / falas. Për vitin 2017 mund të themi se ne kryesisht menduam dhe diskutuam ide të ndryshme, përpara se të vendosnim të përqendroheshim vetëm në çështjen e Këshillit Global të Diasporës Shqiptare në vitin 2018.

PLANI I PROPOZUAR I PUNËS

Plani ynë i punës është i ndarë në tri faza si më poshtë.

Faza 1: Përgatitja e bazës për themelimin e Këshillit (Maj 2018 - Dhjetor 2018);

Faza 2: Krijimi i Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare (Janar 2019 - Dhjetor 2019);

Faza 3: Bërja e Këshillit të Diasporës FunkSIONAL (Janar 2020 - Dhjetor 2021).

Faza 1: Përgatitja e Bazës për Themelimin e Këshillit (Maj 2018 - Dhjetor 2018)

1. Përgatitja e një Memorandumi Mirëkuptimi që do të nënshkruhet nga Germin dhe Ministrat e Diasporës së Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë që do të qeverisnin krijimin e Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare;
2. Emërimi i një Task Force prej 5-7 personash për të mbikëqyrur punën që do të kryhet - Germin do të rekomandojë anëtarët e task forcës dhe do të kërkojë miratimin zyrtar nga Ministritë e Diasporës bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit;
3. Task Forca do të krijojë tre Grupe Pune për të mbuluar një numër çështjesh në lidhje me diasporën shqiptare që do të duhej të adresoheshin për të ecur përpara - (i) politike; (ii) ekonomike; (iii) sociale / kulturore;
4. Shqyrtimi i përvojës së vendeve të tjera që kanë themeluar Këshillat e Diasporës (p.sh. Kroacia, Irlanda, Skocia, Izraeli, Estonia, Armenia, India, Xhamajka, Kenia, Australia, etj ...); dhe
5. Duke u bazuar në përvojën e vendeve të tjera për përgatitjen e *Strategjisë dhe Planit të Veprimt* për krijimin e Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare në vitin 2019, si dhe zhvillimin e propozimeve specifike për aktivitetet e Fazës 2 që mund të dorëzoheshin për mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar i donatorëve dhe Diaspora Shqiptare.

Faza 2: Krijimi i Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare (Janar 2019 - Dhjetor 2019)

Për Fazat 2 dhe 3 ne po rendisim një numër aktivitete të mundshme për të treguar vizionin tonë të përgjithshëm. Megjithatë, është shumë herët për të zhvilluar ide më të detajuara, derisa Faza 1 të përfundojë.

1. Emërimin e anëtarëve të përkohshëm të Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare - rekomanduar nga Task Forca e Fazës 1 dhe nga Ministritë e Diasporës;
2. Krijimi i Kapitujve lokalë dhe kombëtarë të Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare në një numër qytetesh e vende në mbarë botën të cilat do të kishin marrëdhënie zyrtare me Ambasadat e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë në vendet e tyre;
3. Hartimi i akteve nënligjore të hollësishme që rregullojnë veprimtarinë e Këshillit të Diasporës Globale Shqiptare, Këshillit Kombëtar dhe Vendor;
4. Vizita studimore për zyrtarët qeveritarë dhe anëtarët e Këshillit të Diasporës në vendet e përzgjedhura që kanë Këshillat e Diasporës; dhe
5. Zhvillimi i planeve për transformimin e Këshillit në një organ zgjedhor të votuar nga anëtarët e Diasporës.

Faza 3: Bërja e Këshillit të Diasporës Operacionale (Janar 2020 - Dhjetor 2021)

1. Të mbajnë zgjedhje për Anëtarët e Këshillit të Diasporës (që do të kishte përfitimin e shtuar për të ndihmuar në ushtrimin dhe funksionimin e të drejtave të votimit të Diasporës në përgjithësi);
2. Te mbajë rolin organizativ për takimet vjetore të Diasporës në vende të ndryshme dhe Samiteve të Diasporës Shqiptare në Ballkanin Perëndimor; dhe
3. Të punohet ngushtë me zyrtarët qeveritarë dhe agjencitë përgjegjëse për çështjet e diasporës për të siguruar përditësimin e Strategjive Kombëtare të Diasporës dhe Planeve të Veprimit.

BUXHETI

Është paksa e hershme që të përgatitet një buxhet i hollësishëm derisa të marrim përshtypjet nga anëtarët e Diasporës dhe donatorët e mundshëm, por mendojmë se një buxhet i përafërt mund të jetë 50,000 - 100,000 € për Fazën 1 në 2018 me burime shtesë për të ardhmen që do të përcaktohet .

ANËTARËT E GRUPIT PUNUES

Agon Kamberi	Berlin, Gjermani	Studentët shqiptarë dhe Organizata Alumni
Agron Shahaj	Boston, SHBA	Shoqëria Shqiptaro-Amerikane e Massachusetts
Arta Krasniqi	Växjö, Suedi	Kujdesi për Shëndetin & Mjekësia
Avni Dervishi Stockholm,	Suedi	Këshilli Shqiptaro-Suedez
Blerina Dula	Sydney, Australi	Konsulenti i Turizmit Ndërkombëtar dhe Lokal
Dritan Dema Birmingham,	Birmimnngam,UK	Fondacioni i Shqiptarëve Etnik në Midlands.
Edmond Godo Itali	Rome, Itali	Shoqata e Bashkësisë Shqiptare në BESA
Elfije Jashari McGee	Perth, Australi	

Emidio Tedeschini	Roma, Itali	Jurist / Kandidat për PHD në ligje
Mark Kosmo Boston,	SHBA	Shoqëria Shqiptaro-Amerikane e Massachusetts
Mirela Juka	Tiranë, Shqipëri	Fonacioni Down Syndrome i Shqipërisë.
Mirjam Deponte	Zagreb, Kroaci	
Muhamet Idrizi	Eppingen, Gjermani	Platforma TASH Gjermani
Nick Markola	New York, USA	Rrjeti i Sipërmarrësve Profesionistë.

Shtesa

Nenet 18-21 të Ligjit të Diasporës Shqiptare Miratuar nga Parlamenti Shqiptar më 5 Prill 2018

http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2018/PDF-2018/56-2018.pdf

Neni 18

Këshilli Koordinues i Diasporës

1. Këshilli Koordinues i Diasporës (Këshilli) përfaqëson dhe koordinon marrëdhëniet me diasporën.
2. Këshilli ka këto kompetenca:
 - a) identifikon problemet e diasporës, i propozon ministrit përgjegjës për diasporën veprime për zgjidhjen e tyre, përcakton linja orientuese për hartimin e strategjisë për diasporën;
 - b) miraton rregulla procedurale për përmbushjen e veprimtarisë së tij dhe procedurën e vendimmarrjes.
3. Përgjegjësitë profesionale, të përdorimit të fondeve dhe ato administrative, për Këshillin do të ushtrohen nga Agjencia Kombëtare e Diasporës.
4. Agjencia Kombëtare e Diasporës kryen funksionet e sekretariatit teknik.

Neni 19 **Përbërja e Këshillit**

1. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë, të cilët janë përfaqësues të diasporës.
2. Në aktivitetet e Këshillit marrin pjesë Kryeministri, ministrat përgjegjës për diasporën, punët e jashtme, punët e brendshme, për financat dhe ekonominë, arsimin, kulturën, Akademia e Shkencave, Dhoma Kombëtare e Tregtisë dhe Industrisë, Radiotelevizioni Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe përfaqësues të qendrave kulturore të diasporës.
3. Presidenti i Republikës, me kërkesën e tij dhe në koordinim me Kryeministrin dhe ministrin e shtetit përgjegjës për diasporën, merr drejtimin e mbledhjeve të veçanta të Këshillit Koordinues të Diasporës.

Neni 20

Kriteret për zgjedhjen në Këshill

1. Përfaqësuesit e diasporës, të cilët do të jenë anëtarë në Këshill, duhet të përmbushin këto cilësi:
 - a) të kenë integritet të lartë dhe reputacion në komunitetin ku ata jetojnë;
 - b) të kenë aftësi për të përmbushur detyrat për mbajtjen dhe forcimin e marrëdhënieve ndërmjet vendit të origjinës e diasporës.
2. Përfaqësuesit e diasporës zgjidhen sipas këtij rendi:
 - a) tre përfaqësues nga diaspora e Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
 - b) dy përfaqësues nga diaspora e Kanadasë;
 - c) gjashtë përfaqësues nga diaspora e Evropës;
 - ç) një përfaqësues nga diaspora e Turqisë;
 - d) një përfaqësues nga diaspora e Australisë;
 - dh) dy përfaqësues nga Britania e Madhe.
3. Rregullat e hollësishme për kushtet dhe mënyrën e zgjedhjes së përfaqësuesve përcaktohen me vendim të Këshillit të Mini-strave.
4. Vendi i origjinës nuk ushtron influencë në procedurat dhe kushtet e zgjedhjes së përfaqësuesve në Këshill.

5. Vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve i njoftohet ministrit përgjegjës për diasporën të paktën 30 ditë përpara datës së përcaktuar për mbledhjen e Këshillit.

Neni 21

Mbledhja e Këshillit

1. Këshilli mblidhet, si rregull, Ditën Kombëtare të Diasporës.
2. Këshilli mund të mblidhet në sesion të jashtëzakonshëm, me kërkesën e, të paktën, 1/3 së të përfaqësuarve ose me kërkesë të ministrit përgjegjës për diasporën, me një program të përcaktuar paraprakisht.
3. Këshilli, sipas nevojës, mund të krijojë grupe pune për të trajtuar çështje teknike, me natyrë ekonomike, statutore, kulturore, shkencore e sportive. Numri i anëtarëve dhe mënyra e organizimit e funksionimit të grupeve të punës përcaktohet me vendim të Këshillit Koordinues të Diasporës.

* Përkthyer nga DD @ MEAF 29. 04. 2018.